

KLSH merr pjesë në workshop-in për menaxhimin e borxhit publik dhe diskuton me ekspertë ndërkombëtarë çështje të auditimit të buxhetit të shtetit

Në datën 11 Shtator 2024, në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë, u organizua workshopi me temë “Roli i parlamentit në menaxhimin e borxhit publik” nga Fondacioni Wesminter për Demokraci (WFD), Shqipëri në kuadër të projektit “Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një parlamenti më reagues” financuar nga FCDO nëpërmjet Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, ku morën pjesë përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, stafi teknik i Kuvendit, si dhe zyrtarë të Ministrisë së Financave.

Në këtë workshop u diskutua mbi rolin e Parlamentit dhe institucioneve të tjera publike në mbikëqyrjen e borxhit publik, si dhe u prezantua në mënyrë të përgjithshme Instrumenti i Vlerësimit të Menaxhimit të Borxhit Publik për Parlamentin (PDMAT).



Në vijim të këtij workshopi, në datën 12 Shtator 2024, u zhvillua në ambientet e KLSH takimi ndërmjet përfaqësuesve: z. Geoff Dubrow, Ekspert Ndërkombëtar i WFD, z. Lars Jessen, Ekspert i Nivelit të Lartë për Borxhin, Banka Botërore, dhe znj. Laureta Memo, Menaxhere Projekti pranë WFD, si dhe përfaqësuesve të KLSH z. Gjovalin Preçi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe znj. Xhesila Nano e z. Albert Hoxhalli, auditues të këtij Departamenti. Në takim u diskutua mbi çështjen dhe rëndësinë e mbikëqyrjes së borxhit publik dhe rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë këtij procesi. Diskutimi me ekspertët ndërkombëtarë ishte mjaft i vlefshëm me qëllim vijueshmërinë e funksionit të KLSH në çështjet e auditimit të buxhetit të shtetit në tërësi dhe menaxhimin e borxhit publik në veçanti.

